



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 80/10

Prishtinë, më 23.04.2010, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Armend Zemaj, Besa Gaxheri, Shkumbin Demaliaj, Xhevdet Neziraj dhe Suzana Novobërdaliu.

Munguan: Naser Osmani, Mufera Sinik dhe Hajdin Abazi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza, zv. Ministër i MEF-it, Esat Brajshori Kryetar i Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, Teki Shala dhe Ramadan Islami nga GTZ, monitorues nga Zyra e presidentit, OSBE, NDI, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasha Prica Tisma, Vilson Ukaj dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, të mbajtura më datë 30.03.2010 dhe 31.03.2010;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Pagat e Nëpunësve Civil me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;
6. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi njoftoi se ka ftuar me urgjencë kryetarin e komisionit funksional, për të dhënë sqarimet për një amendament shtesë që ka propozuara ky Komision lidhur me Projektligjin për pagat e shërbyesve civil, njëkohësisht do të dëshironin mendimin e kryetarit funksional lidhur me disa amendamente të propozuara, që kanë të bëjnë me kompenzimin e udhëtimit brenda vendit, kompenzimin për shujtë gjatë orarit të punës dhe shpenzimet e udhëtimit.

Esat Brajshori njoftoi se ai është i ftuar për të dhënë sqarime për dy amendamentet që për shkaqe teknike nuk janë përfshirë në raportin e komisionit funksional, që në esencë nuk ndryshojnë nenet e projektligjit, por janë vetëm formulime më përmbytësore dhe çëshjta ka të bëjë me moshën e pensionimit. Sa i përket amendamenteve për pagat, Komisioni për Buxhet dhe Financa është i thirrur për këto çështje dhe do të respektojë rekomandimet tuaja.

Rendi i ditës u miratua me pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit, të mbajtura më datë 30.03.2010 dhe 31.03.2010

Kosara Nikolic theksoi se në procesverbalin e dt. 31.03.2010, në pikën e fundit në diskutimit të saj, nuk është shkruar ajo çka ka thënë.

Besa Gaxherri po ashtu bëri vërejtje në procesverbalin e dt. 31.03.2010, në pikën e fundit në diskutimin e tim nuk është shkruar pjesa e rëndësishme e konstatimeve të saja dhe mendimeve të kryetarit lidhur me këtë çështje. Kërkoj që ato të përfshihen.

Kryesuesi konstatoi se miratohen procesverbalet, më vërrejtet e znj. Nikolic dhe znj. Gaxherri dt. 31.04.2010, dhe të njëjtat të inkorporohen në procesverbal.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente

Kryesuesi vlerësoi se nuk ka kosto buxhetore, çëshjta e diskutueshme është amendamenti 61, që ka të bëjë me angazhimin e stafit civil në pozita drejtuese politike.

Besa Gaxherri mbështeti idenë që shërbyesit civil nuk mund të jenë në pozita drejtuese të larta politike, mirëpo ata mund të jenë aktiv në politikë.

Safete Hadërgjonaj theksoi se amendamenti 62 është në kundërshtim me amendamentin 61, prandaj duhet të harmonizohen këto çëshjte.

Shkumbin Demaliaj pyeti pse kaq me urgjencë erdhën këto ligje dhe pse nuk po miratohen Ligji për deputet dhe Ligji për Qeverinë.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me tetë vota Për, një Kundër (z. Shkumbin Demaliaj) dhe asnjë Abstenim nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, dhe ka konstatuar se projektligji nuk përmban implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara..

Vërejtje konkrete

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon komisionit funksional të rishikojë neni 16 dhe amendamentet që kanë të bëjnë me këtë nen, i cili rregullon çështjen e angazhimit aktiv të shërbyesve civil në politikë.

4. Shqyrtimi i Projektligji për Pagat e Nëpunësve Civil me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente

Kryesuesi theksoi se nëse pranojmë kompensimet për shujtë, kostoja buxhetore për vit do të jetë rreth 22.700.000 € dhe një situatë e tillë do të ishte e papërballueshme për buxhetin e Kosovës dhe mund të sjell vendin në një kolaps financiar, siq është rasti me Greqinë. Jam për rritjen e pagës bazë, por jo me ligj të sanksionohen këto kompenzime. Madje praktika të këtilla nuk kemi as në vendet e zhvilluara që rregullohet çështja e kompensimit për shujtë, mëditja brenda vendit dhe kompensim të udhëtimit.

Bedri Hamza jemi të interesuar të miratohen ligje që mund të imlementohen. Sa i përket këtij ligji, qeveria ka planifikuar mjete për periudhën afatmesme. Për vitin 2010 kemi planifikuar që të kemi një kosto shtesë buxhetore prej 5 mili €, ndërsa prej vitit 2011 një kosto prej 14 mili € në vit. Për ndryshimet që janë propozuar të bëhen në Kuvend, nuk është kërkuar të japim deklaratë shtesë financiare. Por nëse miratohen këto ndryshime që po diskutohen këtu lidhur me kompenzimin e shujtave dhe udhëtimit, do të kemi implikime të mëdha buxhetore dhe të papërballueshme për buxhetin e Kosovës. Gjithashtu do të marrim vërejtje edhe nga FMN-ja që do të ketë ndikime edhe në beneficionet nga jashtë.

Suzana Novobërdaliu theksoi se me rastin e miratimit të buxhetit është dashur që Qeveria të marrë parasysh rritjen e pagave e shërbyesve civil. Nuk mund të bëjmë krahasime me vendet perëndimore në çështjen e kompenzimeve shtesë, pasi që në këto vende paga bazë e shërbyesve civil është e mirë. Pajtohem që të heqen kompenzimet, por me kusht që ato të përllogariten në pagën bazë, sepse edhe me rritje prej 20% paga do të mbetet prapë e vogël duke ditur se baza është e vogël.

Xhevdet Neziraj lidhur me këtë projektligj duhet merren parasysh dy elemente bazë. E para rritja e pagave nuk është papaparare në kornizën afatmesme, prandaj edhe lënia e shumë ligjeve në rishikim, do të jetë e pamundur që të imlementohen. Dhe e dyta ministrat nuk duhet të dalin me deklarata për përmbushjen e kërkesave të stafin civil dhe rritje të pagave të tyre, kur nuk e dinë buxhetin e tyre. Propozoi që ftohen përfaqësuesit e ministrisë sponzoruese, që të shohim se për kur kanë planifikuar që të imlementohet ligji dhe të shikohen mundësitë buxhetore.

Besa Gaxherri interesi jonë është përmisimi i kushteve për qytetarët dhe nuk na intereson a mundet apo jo Qeveria të imlementoj ligjin. Në vendet tjera, përfshirë edhe ato të rajonit apo evropiane nuk

kemi përvoja të kompenzimeve shtesë, por se gjendja e shërbyesve është më e mirë. Duke ditur se shumica e punëtorë udhëtojnë prej fshatrave të largëta, nëse krahasohet paga aktuale, pas zbritje së shpenzimeve të udhëtimit, do ti mbetet paga shumë e vogël. Edhe pse jemi për vendosjen e rregullave, nuk mund të votojmë ligjin nëse nuk kemi rritje të pagave për shërbyesit civil. Qeveri është përgjegjës për këto çështje.

Kryesuesi qëllimi është që të vejmë parimet bazë për nivelin e pagave për shërbyesit civil, për rritje të pagës do të flasim gjatë projeksioneve buxhetore në varësi të situatës ekonomike në vend. Nuk duhet rregulluar çështja e kompenzimeve për pushim të lehonisë, pushim vjetor kur janë të rregulluar me ligjet tjera. Prandaj duhet fshirë edhe amendamentin 39, 44 dhe 45, ndërsa në amendamentin 47 që i referohet nenit 23.1.3 të fshihen fjalët “në vend dhe”, ndërsa paragrafi 23.1.4 të fshihet në tërësi, për shkak të implikimeve të mëdha buxhetore.

Shkumbin Demaliaj kur flasim për çështjen e rritjes së pagave të shërbyesve civil, mos të harrojmë se qeveria ka nënshkruar marrëveshje me sindikatat për përmisimin e kushteve për punëtorët shtetëror, ku janë paraparë edhe shujtat, kompensimet e udhëtimit dhe kompensimet tjera shtesë. Nuk është dashur të bëhen marrëveshje, pa pasur bazë ligjore. Megjithatë unë së bashku me kolegun im që përfaqësojmë subjektin e njëjtë politik jemi pozitiv për miratimin e këtij ligji pasi që nuk ka pasur deri më ligj të kësaj natyre, por për deklaratat dhe marrëveshjet që bënë qeveria rreth premtimeve të përealizueshme, le ti merr vetë përgjegjësitë.

Safete Hadërgjonaj nëse mundohemi të bëjmë ligjin në bazë të marrëveshjeve dhe debateve nuk kemi bërë asgjë. Ne po pretendojmë të bëjmë ligje konform standardeve evropiane, nëse miratojmë amendamentin 47 nuk po respektohen këto standarde dhe rregullat e FMN-së. Të japim propozime si komision që disa gjëra që janë të rregulluara me ligje tjera, të hiqen nga ky projektligj.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe ka konstatuar se projektligji nuk përmban implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë atë .
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit t’i miratojë ato, me përjashtim të amendamentit 39, 44, dhe 45. Komisioni vlerësoi se amendamentet e lartpërmendura të propozuara nga komisioni funksional, përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Vërejtje konkrete

Amendamenti 1

Amendamenti 47 që i referohet nenit 23.1.3, fshihen fjalët “në vend dhe”

Me dy vota për (z. Gani Koci dhe znj. Safete Hadërgjonaj), një Abstenim (znj. Myrvete Pantina) tri Kundër (znj. Besa Gaxherri, znj. Suzana Novobërdaliu dhe z. Xhevdet Neziraj) dhe një e padëklaruar (znj. Kosara Nikolic), nuk u miratua propozimi për fshirjen e amendamentit 47 të komisionit funksional.

Besa Gaxherri theksoi se amendamenti 47 u votua dhe i njëjti nuk mundet të hyjë më në procedurë të shqyrtimit dhe votimit në këtë komision.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Raporti me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energji, Transport e Telekomunikacion nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

6. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar

Kryesuesi propozimet nuk bien ndesh me kushtetutën dhe ligjin, e plotësojnë marrëveshjen e miratua, duhet deklaruar se i përkrahim apo jo dhe më pas ti rekomandojmë Kuvendit.

Bedri Hamza njoftoi se me dt. 24.07.2009, Kuvendi ka ratifikuar marrëveshjen me FMN. Në muajin mars kemi marrë tri propozime për ndryshimin e saj nga FMN-ja përmes BQK-ja, këto propozime kanë të bëjnë më fuqinë dhe pjesëmarrjen, autoritetin e investimeve dhe alokimet e veçanta të njëhershme e të drejtës speciale të tërheqjes. Këto ndryshime janë përkrahur pothuajse nga të gjitha anëtarët e FMN-së, prandaj është në interes tonin që të bëjë këto ndryshime, e që janë në interes të barabarësisë në kuadër të FMN-së. Konform Kushtetutës i kemi procedura dhe kërkomë që Kuvendi ti ratifikojë ato.

Pas diskutimeve dhe vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandon Kuvendit që në seancën plenare, të miratojë propozim-amendamentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

7. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Gani Koci